



Institucioni i Avokatit të Popullit në Republikën e Kosovës  
Institucija Ombudsmana Republike Kosovo  
Ombudsperson Institution of Republic of Kosovo

**INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT KOSOVË**

# **Doracak për mbrojtje nga diskriminimi**

**Prishtinë 2018**

## **PËRMBAJTJA:**

### **Parathënie**

1.	Nocioni i diskriminimit dhe si ta njohim .....	4
1.1.	Si mund të bëhet diskriminimi dhe a paraqet çdo dallim diskriminim .....	5
2.	Diskriminimi dhe mbrojtja nga diskriminimi në legjislacionin vendorë .....	6
2.1.	Llojet e diskriminimit sipas Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi .....	7
2.1.1.	Diskriminimi i drejtpërdrejtë (direkt).....	7
2.1.2.	Diskriminimi i tërthortë (indirekt) .....	9
2.1.3.	Shqetësimi .....	10
2.1.4.	Shkaktimi i diskriminimit – .....	10
2.1.5.	Viktimizimi, .....	11
2.1.6.	Izolimi, .....	11
2.1.7.	Me diskriminim në bazë të shoqërimit-bashkëpunimit .....	12
2.1.8.	Mungesa e akomodimit/adoptimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike – .....	12
2.1.9.	Diskriminimi në bazë të perceptimit .....	13
2.1.10.	Diskriminimi i shumëfishtë.....	13
2.1.11.	Shkelja e parimit të drejtave dhe detyrimeve të barabarta .....	13
2.2.	Format e rënda të diskriminimit .....	14
2.3.	Veprimet afirmative .....	14
3.	Mbrojtja nga diskriminimi .....	15
3.1.	Mbrojtja gjyqësore nga diskriminimi.....	15
3.2.	Barra e argumentimit .....	16
3.3.	Mbrojtja nga diskriminimi para Institucionit të Avokatit të Popullit.....	16
3.3.1.	Ankesat kundër diskriminimit në Institucionin e Avokatit të Popullit.....	17
4.	Legjislacioni për ndalimin e diskriminimit .....	19
4.1.	Legjislacioni ndërkombëtar.....	19
4.2.	Legjislacioni vendor.....	19
4.2.1.	Dispozitat përkatëse së legjislacionit të mëposhtëm .....	20
LITERATURA	.....	21
Shtojcë	.....	21

## PARATHËNIE

---

Mosdiskriminimi është e drejtë njerëzore, por edhe elementi më i rëndësishëm i të gjitha drejtave tjera të njeriut.

Diskriminimi është problem serioz dhe i thellë dhe shkakton pasoja të dëmshme për tërë shoqërinë dhe e ngadalëson zhvillimin e tij. Kundër tij mundemi të luftojmë nëse mundemi ta identifikojmë. Qëllimi i këtij doracakut është që t'i ndihmojë lexuesve në identifikimin e diskriminimit dhe përdorimit të mekanizmave kundër diskriminimit në Republikën e Kosovës, si dhe të ndrisë vetëdijen e publikut mbi diskriminimin, dëmin e saj dhe pasojat shkatërruese të cilat i ka në tërë shoqërinë.

Viteve të fundit është bërë një hap i madh në përmirësimin dhe avancimin e kornizës legislative dhe institucionale për luftimin kundër diskriminimit në Republikën e Kosovës, mirëpo, krijimi i kornizës ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi nuk do të thotë edhe realizim i qëllimit dhe fundi i përpjekjeve për realizimin e barazisë së të drejtave. Jemi dëshmitarë se realitetin shoqërorë në Kosovë e karakterizojnë bashkëjetesa, bashkëpunimi dhe toleranca, por edhe stereotipat etnike dhe të tjera si dhe paragjykimet, si dhe nivel i lartë i distancës shoqërore ndaj pakicave të caktuara nacionale, fetare dhe të thera dhe grupeve të ndjeshme gjinore, gjë që ndjeshëm kufizon realizimin e standardit të barazisë në jetën e përditshme. Prandaj, është e nevojshme që në drejtim të realizimit nga diskriminimi, të gjitha pjesët e shoqërisë, para të cilave ligji përcakton detyra konkrete, të kyçen në kapacitetin e plotë. Është e qartë se në realizimin e kësaj detyre, gjykatat kompetente dhe Avokati i Popullit kanë një prej roleve më të rëndësishme edhe atë jo vetëm që me veprime të duhura do të ofrohet mbrojtje ligjore nga diskriminimi, por edhe duke i propozuar me kohë autoriteteve legislative ndryshimin dhe plotësimin e zgjidhjeve ligjore joadekuate.

Ky doracak ofron njohuri themelore për njohjen dhe reagimin ndaj diskriminimit. Qëllimi i këtij doracakut është që në një vend të përmbledhen të gjitha termat ligjorë, definicionet dhe përgjigjet në çështjet komplekse të cilat kanë të bëjnë me diskriminimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe për të ndihmuar që lexuesit qartë të përkufizojnë diskriminimin nga sjelljet tjera të paligjshme.

Doracakut është vepër e Institucionit të Avokatit të Popullit, Departamentit për mbrojtje nga diskriminimi.

Të gjitha termat e përdorur në këtë tekst në gjininë mashkullore përfshijnë gjininë mashkullore dhe femërore të personave të cilëve i referohet.

## 1. Nocioni i diskriminimit dhe si ta njohim

Fjala diskriminim rrjedh nga fjala latine *discriminare* dhe do të thotë “ndarje” ose “dallim”. Kështu që, diskriminimi në fushën e të drejtave paraqet çdo “dallim të paligjshëm”.

Diskriminimi është fenomen shoqëror i papranueshëm sepse përbën shkeljen e parimit të barazisë, si një prej parimeve më të rëndësishme ligjore dhe morale. Diskriminimi paraqet të kundërtën e barazisë e cila nënkupton trajtim të njëjtë për të gjithë njerëzit, si dhe mundësi të barabarta për të gjithë.

Në kuptim ligjorë, kjo do të thotë se para ligjit janë të gjithë të njëjtë, që të gjithë të kenë të drejtat dhe obligimet e njëjta, të njëjtën të drejtë në mbrojtjen e drejtave të tyre dhe drejtën në trajtim të njëjtë.

Pas kësaj, thelbi i diskriminimit reflektohet në trajtimin e pabarabartë ndaj të barabartëve, dhe në trajtimin e barabartë ndaj të pabarabartëve. Në mënyrë që sjellja e dikujt të përbëjë diskriminim sipas ndonjëres nga bazat e mbrojtura ligjërish, është i parëndësishëm qëllimi i diskriminuesit (personi që bën diskriminim), gjegjësisht a ka pasur për qëllim apo jo që të bëjë diskriminim, por është i rëndësishëm rezultati përfundimtarë i sjelljes së tillë gjegjësisht që sjellja e tillë paraqet akt të diskriminimit.

Baza e mbrojtur ligjore ka të bëjë me karakterin personal dhe paraqet nevojën me qëllim të krijimit të lidhjes shkakësore midis trajtimit të pafavorshëm dhe bazës së mbrojtur ligjore, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë.<sup>1</sup>Karakterin personal në të cilin bazohet diskriminimi quhet “baza e diskriminimit”.

Bazat e mbrojtura ligjore sipas së drejtës evropiane kundër diskriminimit si dhe legjislacionit vendorë janë: nacionaliteti apo lidhjet me ndonjë komunitet shoqërorë apo prejardhje nacionale, raca, përkatësia etnike, ngjyra e lëkurës, lindja, origjina, gjinia, përkatësia gjinore, identiteti gjinorë, orientimi seksual, gjuha, nënshtetësia, religjioni dhe besimet fetare, përkatësia politike, mendimi politik apo tjetër, statusi social apo personal, mosha, statusi familjarë apo martesorë, shtatzënia, amësia, pasuria, gjendja shëndetësore, aftësitë e kufizuara, trashëgimia gjenetike apo në bazën tjetër, me qëllim të zbatimit të parimeve të trajtimit të barabartë.<sup>2</sup>

Megjithatë, dispozita apo praktika e cila aplikohet nuk duhet domosdoshmërisht të ketë të bëjë me “bazën e mbrojtur”. Mjafton të referohet në ndonjë shkak i cili nuk mundet të dallohet nga baza e mbrojtur. Gjykatat përkatëse kanë dhënë interpretim të gjerë “të bazave të mbrojtura” të cilat mundet të përfshijnë “diskriminimin në bazë të kohezionit”, gjegjësisht rasti kur viktimat e diskriminimit vetë nuk ka shenjë mbrojtëse. Gjithashtu mundet të përfshijë edhe rastet kur baza e caktuar interpretohet në mënyrë abstrakte.

Shkaqet kryesore të diskriminimit janë paragjykimet dhe stereotipat e ndryshëm të cilat njerëzit i kanë ndaj grupeve të caktuara të njerëzve.

---

<sup>1</sup>Shih nenin 1. paragrafi 1. Ligji mbi mbrojtjen nga diskriminimi, nr. 05/L-21

<sup>2</sup>Shih nenin 1. paragrafi 1. LMD

## 1.1. Si mund të bëhet diskriminimi dhe a paraqet çdo dallim diskriminim

Diskriminimin mundet ta shkaktojë ndonjë sjellje aktive apo pasive; së pari mundet të jetë akt i cili e diskriminon dikë, pastaj lejon sjelljen e caktuar e cila mundet të sjell deri tek diskriminimi. Deri tek diskriminimi gjithashtu mundet të vijë në rastet kur personat dhe grupet e ndryshme janë trajtuar në mënyrë të barabartë, dhe pastaj nuk janë respektuar dallimet reciproke të cilat kërkojnë trajtim të ndryshëm.

Diskriminimi është term i cili shpeshherë keqpërdoret për shënjim të secilës formë të shkeljes së të drejtave sepse diskriminimi është shkelje e të drejtës saktësisht të caktuar, dhe kjo është e drejta e trajtimit të barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

Duhet theksuar se çdo dallim nuk paraqet domosdoshmërisht diskriminim, sepse në situata të caktuara dallimi është i justifikuar dhe ekziston justifikim për përkufizim dhe përjashtim të drejtave të caktuara apo vendosje të obligimeve të caktuara ndonjë personi apo grupi të personave. Kështu, në situata të tilla justifikimi apo mos-justifikimi i kufizimit apo mohimi i të drejtave të caktuara gjegjësisht vendosja e obligimeve të caktuara është çështje kyçe. Kriteret kryesore për identifikimin e justifikimit gjegjësisht mos-justifikimit të këtyre masave janë: qëllimi apo pasojat e veprimeve të caktuara në rastin konkret dhe proporcioni midis veprimeve të caktuara në rastin konkret dhe qëllimi i cili me aktivitetet e caktuara dëshirohet të arrihet. Në rast kur qëllimi apo pasojat e veprimeve konkrete nuk kanë justifikim të arsyeshëm dhe ligjorë dhe kur proporcioni midis veprimeve konkrete nga njëra anë dhe qëllimit i cili në rastin konkret dëshirohet të arrihet bëhet fjalë për diskriminim.

Shembulli i dallimit të justifikuar: Hapësirat e parkimit për veturat e personave me invaliditet janë shënuar në mënyrë të posaçme dhe gjenden më së afërti hyrjeve në objekte në përdorim publik. Edhe pse kjo paraqet dallim dhe privilegj për një grup të njerëzve, në këtë rast është mjaftë e justifikueshme që personave me invaliditet, për arsye se lëvizin me vështirësi, t'i sigurohet qasje më e lehtë dhe e papenguar dhe nuk paraqet diskriminim.

Diskriminues mundet të jetë gjithkush, gjithashtu viktimë e diskriminimit mund të jetë çdo person juridik dhe fizik.

Deri tek diskriminimi mundet të vijë në të gjitha fushat e jetës shoqërore. Ligji për mbrojtje nga diskriminimi në Republikën e Kosovës<sup>3</sup> thekson disa nga fushat, p.sh: puna dhe punësimi, edukimi dhe aftësimi profesional, mbrojtja shëndetësore dhe sociale, gjyqësor, shkenca, sporti, arti, kultura, të drejtat pronësore, siguria personale, etj. por nuk kufizohet vetëm me ato të cilat janë theksuar në ligj por edhe në çdo të drejtë tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup> Ligji për mbrojtje nga diskriminimi nr. 05/L-021.

<sup>4</sup> Shih nenin 2. LMD

## 2. Diskriminimi dhe mbrojtja nga diskriminimi në legjislacionin vendorë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), i garanton secilit mbrojtje të barabartë ligjore, pa diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, bindjes politike apo ndonjë bindje tjetër, prejardhjes nacionale apo shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pasurisë, statusit ekonomik dhe social, orientimit seksual, lindjes, aftësive të kufizuara apo ndonjë statusi tjetër personal. Megjithatë, parimi i barazisë para ligjit nuk pengon zbatimin dhe miratimin e masave të përkohshme, të nevojshme për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të individëve dhe grupeve të cilat nuk janë të barabarta. Masat e tilla mund të zbatohen vetëm deri sa të arrihet qëllimi për të cilin janë themeluar.<sup>5</sup> Gjithashtu, edhe disa dispozita tjera të Kushtetutës drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë të bëjnë me ndalesën ndaj diskriminimit.

Me kushtetutën e Republikës së Kosovës është përcaktuar përdorimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve me të cilat garantohen të drejtat e liritë e njeriut, të cilat njëkohësisht paraqesin edhe kornizën ligjore ndërkombëtare e cila është e nevojshme për luftën kundër diskriminimit. Instrumentet ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë paraqesin pjesë të sistemit të brendshëm ligjorë të Kosovës dhe kanë fuqinë, në rast të konfliktit, mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet tjera të institucioneve publike, e ato janë: Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut; Konventa evropiane për mbrojtjen e drejtave dhe lirive të njeriut dhe protokollat e Konventës së njëjtë mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racorë, Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike dhe protokollat e të njëjtës, Konventa kornizë e Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e pakicave nacionale, Konventa mbi të drejtat e fëmijëve, Konventa kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, johumane dhe poshtëruese.<sup>6</sup> Të drejtat e liritë themelore të njeriut janë të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut.<sup>7</sup>

Me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi (LMD) është themeluar një sistem gjithëpërfshirës i mbrojtjes nga diskriminimi në Republikën e Kosovës. Ky ligj e definon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim apo dhënie e përparësisë, mbi çfarëdo baze, i cili ka për qëllim apo efekt që të sigurojë apo rrezikojë njohjen, gëzimin ose kryerjen e drejtave dhe lirive themelore të njeriut të cilat janë të njohura me Kushtetutë dhe legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.<sup>8</sup>

LMD zbatohet për të gjitha veprimet dhe mosveprimet, të gjitha institucioneve lokale dhe shtetërore, personave fizik dhe juridik, sektorit publik dhe privat, të cilët janë shkelur, shkelin apo mund të shkelin të drejtat e cilit do person apo personave fizik apo juridik, në të gjitha fushat e jetës.<sup>9</sup>

---

<sup>5</sup> Shih nenin 24. të Kushtetutës së R. Kosovës, 2008.

<sup>6</sup> Shih nenin 22. të Kushtetutës

<sup>7</sup> Shih nenin 53. të Kushtetutës

<sup>8</sup> Shih nenin 3. paragrafi 2. LMD

<sup>9</sup> Shih nenin 2. LMD

Përveç LMD-së, Ligji i posaçëm për barazinë gjinore garanton, mbron dhe promovon barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe definojnë masat e përgjithshme dhe të posaçme për mbrojtje dhe sigurim të drejtave të barabarta të grave dhe burrave dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre. Ky ligj shprehimisht precizon ndalesën, diskriminimin indirekt apo direkt në bazë të gjinisë, kurse dhunën në baza gjinore e precizon si formë të posaçme të diskriminimit. Me këtë ligj, përveç mekanizmave të tjerë institucional, rol i rëndësishëm i është dhënë edhe Avokatit të Popullit, i cili është i autorizuar të trajtojë rastet të cilët kanë të bëjnë me diskriminimin gjinorë.<sup>10</sup>

## 2.1. Llojet e diskriminimit sipas Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi

LMD përcakton llojet e trajtimit të pabarabartë:

**2.1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë (direkt)** ekziston – kur ndonjë person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet apo është trajtuar apo do të jetë trajtuar ndonjë person tjetër në një situatë të krahasueshme sipas një apo më shumë “baza të mbrojtura ligjore”.<sup>11</sup>

Sipas praktikës së Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) duhet të ekzistojë “dallimi në trajtim të individëve në situatë të ngjashme” i cili “bazohet në veçoritë dalluese”.<sup>12</sup> “Dallimi në trajtim” mundet t’i referohet hedhjes poshtë, refuzimit, përjashtimit, ofrimit të kushteve më pak të favorshme apo shërbimeve më të këqija, mohimit të përzgjedhjes apo mundësisë.<sup>13</sup> Përveç moshës, nuk ekziston asnjë justifikim i përgjithshëm për diskriminim të drejtpërdrejtë.

Tek diskriminimi i drejtpërdrejtë nuk është i rëndësishëm motivi apo qëllimi i diskriminuesit por çështja nëse një person i caktuar ishte në një pozitë më të pafavorshme.

Elementet thelbësore të diskriminimit të drejtpërdrejtë janë: pozita e pafavorshme në të cilën është gjetur ndonjë person apo grup i personave, për shkak të ndonjë karakteristike personale, në raport me personat tjerë në situatë të njëjtë apo të ngjashëm të cilët nuk i kanë ato karakteristika personale.

Në procedurën e argumentimit të diskriminimit të drejtpërdrejtë nevojitet “krahasues”, gjegjësisht person në rrethana të ngjashme faktike sikurse viktimat e diskriminimit, duke qenë dallimi kryesorë midis tyre “baza e mbrojtur ligjorë”.

Shembull: në rastin *Luczak kundër Polonisë*, fermeri francez, i cili ka jetuar dhe punuar në Poloni, u ankua se i është refuzuar qasja në sistemin e posaçëm të sigurimit social në Poloni, të krijuar mbështetje vetëm fermerëve polak, pa drejtë të qasjes së shtetasve të huaj. GJEDNJ ka

<sup>10</sup> Shih nenin 13. Ligji për barazinë gjinore, nr. 05/L020

<sup>11</sup> Shih nenin 4. paragrafi 1. pika 1. LMD

<sup>12</sup> GJEDNJ, *Carson dhe të tjerët kundër MB-së* [GC] (nr. 42184/05), 16. mars 2010., fq. 61. Analogno, GJEDNJ, *D.H. kundër Çekisë* [GC] (nr. 57325/00), 13. nëntor 2007., fq. 175.; GJEDNJ, *Burden kundër MB-së* [GC] (nr. 13378/05), 29. prill 2008., fq. 60.

<sup>13</sup> Shih GJEDNJ, *Carson dhe të tjerët kundër UK-a* [GC] (nr. 42184/05), 16. mars 2010., fq. 61. Analogno, GJEDNJ, *D.H. dhe të tjerët kundër Çekisë* [GC] (nr. 57325/00), 13. nëntor 2007., fq. 175.; GJEDNJ, *Burden kundër MB-së* [GC] (nr. 13378/05), 29. prill 2008., fq. 60.

rënë dakord se parashtruesi i kërkesës ishte në një situatë të krahasueshëm me fermerët polak të cilët kishin të drejtë në përdorimin e privilegjeve të sistemit të përmendur, sepse kishte qëndrim të përhershëm në Poloni, ku ka paguar tatimet sikurse edhe shtetasit vendorë, duke i kontribuar financimit të sistemit të sigurimit social dhe se më herët ka marrë pjesë në sistemin e detyrueshëm të sigurimeve sociale.<sup>14</sup>

Megjithatë, ekziston një përjashtim për të cilin nuk kërkohet një “krahasues” i përshtatshëm, dhe kjo është, të paktën në kontest të drejtave të Bashkimit Evropian në fushën e punësimit, në rastet e diskriminimit për shkak të shtatzënisë, sepse mashkulli biologjik nuk mundet të jetë shtatzënë. Në praktikën e pasur juridike të Gjykatës Evropiane të drejtësisë (GJED), duke filluar nga rasti i njohur Dekker, tashmë është vërtetuar se dëmi i pësuar për shkak të shtatzënisë konsiderohet diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë gjinore, dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për krahasues.<sup>15</sup>

Duke përcaktuar se a ka ardhur deri tek diskriminimi i drejtpërdrejtë, dispozita apo praktika e zbatuar nuk duhet lidhur domosdoshmërisht me “bazën e mbrojtur”. Mjafton t’i referohemi ndonjë shkak i cili nuk mundet të ndahet nga baza e mbrojtur. Në fakt, vlerësohet se a ishte arsye e veprimeve të pafavorshme “baza e mbrojtur ligjërish” e cila nuk mundet të ndahet nga faktori specifik i cili është shkak i ankesës.

Shembulli 1.: në rastin *Maruko*, çifti homoseksual hyri në “Bashkësinë jetësore”. Pas vdekjes së partnerit, parashtruesi nga kompania e cila ka udhëhequr sigurimin pensional të ndjerit ka kërkuar “pension familjarë”. Kërkesa e tij është refuzuar në bazë të faktit që pensionet familjare i paguhen vetëm bashkëshortëve, kurse parashtruesi nuk ishte në bashkëshortësi me të ndjerin. Gjykata Evropiane e drejtësisë u pajtua se me privimin e pensionit familjarë me parashtruesin është vepruar në mënyrë të pafavorshme në raportin me krahasuesin e çiftëve “të martuara”. Më pas, ai konsideroi se institucioni i “Bashkësisë familjare”, në Gjermani, partnerëve jetësorë dhe martesorë i kishte imponuar shumë të drejta dhe obligime të barabarta, posaçërisht në pikëpamje të sistemit shtetërorë pensional. Për këtë arsye ai erdhi deri tek përfundimi se në rastin konkret, partnerët në bashkësinë jetësore janë në situatë të njëjtë me bashkëshortët. Gjykata më pas përfundoi se në këtë rast ka ardhur deri tek diskriminimi në bazë të orientimit seksual. Fakti që ky çift nuk ka mundur të martohet, nuk është mundur të ndahet nga orientimi i tyre seksual.<sup>16</sup>

Shembull 2.: Në rastin *P. kundër S.* dhe i Këshillit Rajonal Cornwall, parashtruesja ishte në proces të operacionit për ndërrimin e gjinisë nga mashkullore në femërore kur u pushua nga punëdhënësi. Gjykata Evropiane e drejtësisë (GJED) gjeti se shkarkimi i tillë ka paraqitur trajtim të pafavorshëm. Sa i përket krahasuesit përkatës, GJED theksoi se “kur dikush largohet nga puna në bazë të qëllimit të nënshtrimit apo gjatë nënshtrimit të operacionit të ndërrimit të gjinisë, me atë veprohet në mënyrë të pafavorshme në krahasim me ato të njëjtës gjini të cilës personi në fjalë i takon para nënshtrimit të operacionit”. Për sa i përket bazës, është përfunduar se nuk është mundur të

---

<sup>14</sup> GJEND, *Luczak kundër Polonisë* (nr. 77782/01), 27. nëntor 2007.; shih gjithashtu, GJEND, *Gaygusuz kundër Austrisë* (nr. 17371/90), 16. shtator 1996.

<sup>15</sup> GJED, *Dekker kundër Stichting Vormingscentrum voor Jong Volwassenen (VJV-Centrum) Plus*, lënda C-177/88 [1990.] ECR I-3941, 8. nëntor 1990. Analogno, GJED, *Webb EMO Cargo (UK) Ltd*, lënda C-32/93 [1994.] ECR I-3567, 14. korrik 1994.

<sup>16</sup> GJED, *Maruko kundër Versorgungsanstalt der deutschen Bühnen*, lënda C-267/06 [2008.] ECR I-1757, 1. prill 2008.



argumentohet se me parashtruesin është vepruar ndryshe për shkak të gjinisë së saj, është mundur të argumentohet se veprimi kishte të bëjë me nocionin e gjinisë së saj.<sup>17</sup>

Diskriminimi i drejtpërdrejtë është absolutisht i ndaluar në kuptim që me asgjë nuk mundet të justifikohet.

**2.1.2. Diskriminimi i tërthortë (indirekt)**— kur ndonjë dispozitë e paanshme në dukje, kriter apo praktikë trajton, e ka trajtuar apo do ta trajtojë në pozitë të pabarabartë personin apo grupin e personave në krahasim me të tjerët, sipas një apo më shumë bazave të mbrojtura me ligj, përveç se ndonjë dispozitë e tillë, kriter apo praktikë mundet justifikuar objektivist me qëllim legjitim kurse mjetet për arritjen e këtij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme.<sup>18</sup>

Në mënyrë që të jetë e arsyeshme objektivist dispozita, kriteri apo procedura duhet të ketë qëllim objektiv dhe duhet të jetë mjet i përshtatshëm dhe i domosdoshëm për arritjen e qëllimit. Nëse nuk është kështu, bëhet fjalë për diskriminim të tërthortë. Gjithashtu duhet pasur parasysh se dispozita, kriteri apo procedura mundet të jenë të arsyeshme objektivist në një situatë ndërsa në tjetrën nuk janë.

Kushti i parë për përcaktimin e diskriminimit të tërthortë është rregull, kriter apo praktikë në dukje neutrale.

Kushti i dytë për përcaktimin e diskriminimit të tërthortë është rregull, kriter apo praktikë në dukje neutrale në pozitë të pafavorshme për personin apo grupin e personave në bazë të ndonjë baze të mbrojtur ligjore. Këtu dallon diskriminimi i drejtpërdrejtë me atë të tërthortë, sepse është fokusuar në pasojat, dhe jo në trajtimet e ndryshme.

Dhe, si kusht i tretë, sikurse edhe tek diskriminimi i tërthortë, edhe tek argumentimi i diskriminimit të tërthortë është i nevojshëm krahasuesi, në mënyrë që të përcaktohet se a është duke ndikuar rregulla, kriteri apo praktika e caktuar shumë negativisht në personin e caktuar në raport me të tjerët në situatë të ngjashme.

Shembull: në lëndën D.H. dhe të tjerët kundër Çekisë, për përcaktimin e nivelit të inteligjencës dhe përfitimeve të nxënësve, në bazë të cilës është vendosur a duhet të transferohen nga shkollat e rregullta në ato speciale, është përdorur një gamë e testeve. Shkollat speciale i janë dedikuar fëmijëve me vështirësi intelektuale dhe të tjera në mësim. Testi i njëjtë është përdoruar edhe për të gjithë nxënësit të cilët ishin kandidat potencial për shkollat speciale. Mirëpo, testi në fakt ishte i përshtatur me shumicën e banorëve të çekisë për ç’ arsye ishte shumë e sigurve se nxënësit rom do ta zgjidhnin më dobët. Kjo edhe kishte ndodhur, dhe kështu prej 80 deri 90 përqind e fëmijëve rom janë shkolluar jashtë sistemit të arsimit të rregullt. GJEDNJ konsideron se në këtë rast bëhet fjalë për diskriminim të tërthortë.<sup>19</sup>

**2.1.3. Shqetësimi** parqet diskriminim kur ndonjë sjellje e padëshiruar (e cila përfshinë por nuk kufizohet me sjelljen e padëshirueshme seksuale dhe/apo psikologjike), e cila ka për qëllim apo

<sup>17</sup> GJED, P. kundër S. dhe Këshilli regional Cornwall, lënda C-13/94 [1996.] ECR I-2143, 30. prill 1996.

<sup>18</sup> Neni 4. paragrafi 1. pika 2. LMD

<sup>19</sup> GJEDNJ, D.H. dhe të tjerët kundër Çekisë [GC] (nr. 57325/00), 13. nëntor 2007., fq. 79.

pasojë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi të frikshëm, armiqësorë, degradues, poshtërues apo ofendues, në bazë të bazave ligjore të mbrojtura.<sup>20</sup>

Është shqetësues lloji i posaçëm i diskriminimit në direktivat kundër diskriminimit të Bashkimit Evropian dhe konsiderohet veprim diskriminues kur: ndodhë sjellja e padëshiruar e cila ka të bëjë me cilëndo bazë të mbrojtur ligjrisht, e cila ka për qëllim apo vërtetë paraqet shkelje të dinjitetit të personave, me efekt të krijimit të ambientit frikësues, armiqësorë, nënçmues, degradues, apo ofendues.<sup>21</sup>

Nuk është e domosdoshme ekzistenca e krahasimit në mënyrë që të dëshmohet shqetësimi, për arsye se nga mënyra në të cilën paraqitet, në mënyrë verbale, jo-verbale apo fizike, si dhe për shkak të pasojave potenciale të cilat janë të bëjnë me shkeljen e dinjitetit dhe paraqet sjellje të padëshirueshme.

Sjellja e padëshirueshme mundet të jetë çfarëdo sjellje, duke përfshirë fjalët e folura apo të shkruara apo fyerjet, fotografitë, mbishkrimet, lëvizjet fizike, mimikën, shakatë, britmat apo edhe kontaktin fizik.

Shembull: Në rastin i cili është udhëhequr në Gjykatën Suedeze, një person ka dëshiruar të blejë një këlysh. Kur shitësi e kuptoi se blerësi është homoseksual, refuzoi që t'i shesë këlyshin për shkak të mirëqenies së kafshës, duke deklaruar se homoseksualët janë seksualisht të përgjithshëm me kafshët. Refuzimi i shitjes së këlyshit është konsideruar diskriminim i drejtpërdrejtë në kontekst të mirave dhe shërbimeve, kurse gjykata suedeze përfundoi se në mënyrë specifike ngacmimi ishte bazuar në bazë të orientimit seksual.<sup>22</sup>

**2.1.4. Shkaktimi i diskriminimit** –diskriminim konsiderohet mbi çdo bazë të mbrojtur ligjrisht dhe përfshinë çdo promovim të urrejtjes kur bëhet me qëllim.<sup>23</sup>

Gjuha e urrejtjes është sjellje shoqërore e papranueshme sepse inkurajon diskriminimin dhe mundet të jetë bazë për lloje të ndryshme të diskriminimit. Gjuha e urrejtjes nënkupton të gjitha format e shprehjes me të cilat përhapet, nxitet, promovohet apo arsyetohet urrejtja racore, ksenofobia, homofobia, antisemitizmi, seksizmi dhe format tjera të urrejtjes të cilat bazohen në intolerancë, duke përfshirë edhe intolerancën e shprehur në formën e nacionalizmit dhe etnocentrizmit, gjegjësisht diskriminimin dhe armiqësinë ndaj pakicave, emigrantëve dhe personave me origjinë emigrante.

Është e rëndësishme të dihet se nuk është çdo shprehje e ideve, qëndrimeve dhe opinioneve gjuhë e urrejtjes, madje kur ato ide, qëndrime apo opinione nuk janë të pranueshme për shumicën e njerëzve. Përderisa me këto qëndrime nuk nxitet diskriminimi, intoleranca dhe dhuna ndaj individëve dhe grupeve për shkak të tipareve të tyre, ato mund të shprehen lirisht.

---

<sup>20</sup> Shih nenin 4. paragrafi 1. pika 3. e LMD

<sup>21</sup> Shih: Direktiva mbi barazinë racore, neni 2.(3); Direktiva mbi barazinë me rastin e punësimit, neni 2.(3); Direktiva mbi qasjen në të mirat dhe shërbimet, neni 2.(c); Direktiva mbi barazinë gjinore, neni 2.(1)(c).

<sup>22</sup> Gjykata në Svei (Suedi), *Avokati i popullit kundër diskriminimit në bazë të shqetësimit gjinorë kundër A.S.*, lënda nr. T-3562-06, 11. shkurt 2008. Përmbledhja në anglisht e qasshme në *European Anti-Discrimination Law Review*, nr. 8 (korrik 2009.), fq. 69.

<sup>23</sup> Shih nenin 4. paragrafi 1. pika 4. LMD

Në të gjitha direktivat kundër diskriminimit të Bashkimit Evropian theksohet se “nxitja e diskriminimit” konsiderohet diskriminim”.<sup>24</sup>

Shembull: në rastin *Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë*, kryetari i Varshavës në një paraqitje homofobike kishte deklaruar se nuk do të kishte lejuar mbajtjen e paradës për ngritjen e vetëdijesimit mbi diskriminimin në bazë të përcaktimeve gjinore. Organi kompetent administrativ është deklaruar kundër paradës për arsye tjera, gjegjësisht me qëllim të parandalimit të konflikteve midis demonstruesve. GJEDNJ ka përfunduar se deklaratat e kryetarit kanë mundur të ndikojnë në vendimin e organit përkatës dhe se vendimi është bazuar në orientimin gjinorë me ç’ rast është shkelur e drejta në lirisë së tubimit në lidhje me drejtën në lirinë nga diskriminimi.<sup>25</sup>

**2.1.5. Viktimizimi**, është formë e posaçme e diskriminimit, kurse paraqitet kur personi përjeton trajtim të pafavorshëm apo pasoja negative si reagim në parashtrim të ankesës apo veprimet me qëllim të realizimit të parimit të trajtimit të barabartë, por në raste kur personi i tillë ofron informata, argumente apo ndihmë në lidhje me procedurën ankimore në rast të diskriminimit.<sup>26</sup> Me ndalimin e viktimizimit mbrohet viktima e diskriminimit, por edhe personat e tretë të cilat viktimës së diskriminimit i kanë ndihmuar apo janë në gjendje t’i ndihmojnë që të realizojë mbrojtje ligjore kundër diskriminimit.

Tek argumentimi i këtij lloji të diskriminimit nuk është e nevojshme që të identifikohet krahasuesi në mënyrë që të tregohet nëse personi i është nënshtuar trajtimit më të pafavorshëm si pasojë e procedurës ankimore.

Shembull: Një i ri i cili jeton me HIV/AIDS ka iniciuar procedurë për mbrojtje nga diskriminimi, sepse në punë i ekspozohet ngacmimit të vazhdueshëm. Të punësuarit tjerë shmangin kontaktin me të, shpeshherë i drejtojnë komente negative, dhe jo rrallë herë edhe ofendime. Edhe udhëheqësit e trajtojnë atë në mënyrë të ngjashme. Pas inicimit të procedurës për mbrojtje nga diskriminimi, drejtori e vendosë atë në tjetër zyre, në të cilën është vetëm.

**2.1.6. Izolimi**, konsiderohet diskriminim sipas ndonjë nga bazat e mbrojtura ligjërisht, i cili përfshinë mbrojtjen e secilit person i cili nuk merr pjesë në ndonjë ankesë diskriminimi kurse mendohet se është ankuar, gjë që ka ndodhur në rastet kur një apo disa persona janë ndarë nga të tjerët përmes personave fizik, juridik, apo me kombinimin e dyjave, deklarative, privat apo të dy sektorëve, dhe ndarja e tillë bëhet sipas njëres nga bazat ligjore të mbrojtura.<sup>27</sup> Shkurtimisht, izolimi është çdo ndarje e njerëzve në bazë të kriterëve të ndryshme, që bien ndesh me parimet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Shembuj të izolimit mund të jenë ndarja e fëmijëve rom nga ata jo rom në shkolla; kolonizimi i grupeve minoritare në geto, duke përfshirë edhe rastet të nuk janë akt i drejtpërdrejtë i shtetit, por pasojë e politikave diskriminuese të shtetit dhe strukturave lokale.

<sup>24</sup> Neni 2.(4) i Direktivës mbi barazinë me rastin e punësimit; neni 4.(1) i Direktivës mbi qasjen e barabartë në të mira dhe shërbime; neni 2.(2)(b) i Direktivës mbi barazinë gjinore; neni 2.(4) i Direktivës mbi barazinë racore.

<sup>25</sup> GJEDNJ, *Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë* (nr. 1543/06), 3. maj 2007.

<sup>26</sup> Shih nenin 4. paragrafi 1. pika 5. LMD

<sup>27</sup> Shihni nenin 4. paragrafi 1. pika 6. e LMD

**2.1.7. Me diskriminim në bazë të shoqërimit-bashkëpunimit**, konsiderohet diskriminimi në bazë të ndonjë baze të mbrojtur ligjërish, etiketimi i personave të cilat nuk i përkasin grupit të caktuar apo janë persona të tretë të cilat lidhen me këto grupe.<sup>28</sup>

Diskriminimi shoqëruar i referohet personit i cili nuk posedon karakteristikë të caktuar, por është diskriminuar sepse (me lidhjet familjare apo të tjera) është lidhur me personin i cili posedon karakteristikën e tillë. Si rrjedhojë e kësaj, disa autorë preferojnë që forma e tillë të quhet diskriminim “transformues” sepse pasoja e posedimit të ndonjë karakteristike “bartet” në personin tjetër.

Shembull: Në rastin *Coleman*, nëna ka pohuar se ajo ishte trajtuar në mënyrë të pafavorshme në punë për shkak të invaliditetit të djalit të saj. Për shkak të invaliditetit të tij nëna është vonuar në punë dhe ka kërkuar pushimin vjetorë në përputhje me nevojat e djalit të saj. Kërkesat e saj janë refuzuar dhe i është kërcënuar me largim nga puna, të shoqëruar me komente fyese në llogari të gjendjes së djalit të saj. Gjykata Evropiane e drejtësisë e pranoi atë si krahasim të kolegut të saj me fëmijë në vende të ngjashme të punës, duke përfunduar se ku ata kërkuan një gjë të tillë, i është mundësuar fleksibilitet. Gjykata gjithashtu ka pranuar se në këtë rast është bërë fjalë për diskriminim dhe shqetësim në bazë të invaliditetit të fëmijës.<sup>29</sup>

**2.1.8. Mungesa e akomodimit/adoptimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike** – konsiderohet diskriminim në kuptim të bazës së mbrojtur, përveç nëse përbën ngarkesë të pajustificuar të personit i cili është i obliguar të sigurojë atë, nuk është në kundërshtim me ligjet në fuqi, duke pasur parasysh për këtë qëllim faktorët e tillë sikurse përdorimi i burimeve të disponueshme publike, pjesëmarrjen në jetën publike dhe shoqërore dhe garantimin e qasjes në vend të punës dhe kushtet e përshtatshme të punës.<sup>30</sup>

Shembull: Në rastin *Zehnalova dhe Zehnal kundër Republikës së Çekisë* (2002) parashtruesit e kërkesës kanë pohuar se është shkelur e drejta e tyre në jetë private pa diskriminim për arsye se shumë ndërtesa nuk janë të rregulluara në mënyrë që invalidët të mundën t’i shfrytëzojnë (edhe pse këtë e kërkojnë edhe ligjet e Çekisë). Duke iu referuar nenit 14. të Konventës në lidhje me nenin 8, parashtruesja e kërkesës ka theksuar se, si person me invaliditet, është diskriminuar në ashtu që nuk mundet të gëzojë të drejtat themelore, të garantuara për të gjithë. Gjykata ka përfunduar se në këtë rast nuk është i zbatueshëm neni 8, dhe për këtë nuk është i zbatueshëm edhe neni 14.<sup>31</sup>

**2.1.9. Diskriminimi në bazë të perceptimit** – konsiderohet diskriminim në bazë të ndonjë karakteristike të supozuar të cilën nuk e posedon ai person, por diskriminuesi konsideron se ai person e ka ato karakteristikë personale. Pra në objektiv vendosen, jo personat të cilat i përkasin grupit të caktuar, por personat për të cilat konsiderohet se i përkasin grupit të caktuar.<sup>32</sup>

Shembull: Në rast se personi i cili ka miq e mikeshat të orientimit homoseksual diskriminohet edhe vetë, sepse diskriminuesi konsideron se edhe ai person është i orientimit homoseksual.

---

<sup>28</sup> Shihni nenin 4. paragrafi 1. pika 7. e LMD

<sup>29</sup> GJED, *Coleman kundër Attridge Law dhe Steve Law*, lënda C-303/06 [2008.] I-5603, 17. korrik 2008.

<sup>30</sup> Shihni nenin 4. paragrafi 1. pika 8. e LMD

<sup>31</sup> GJEDNJ *Zehnalová and Zehnal v. Czech Republic* (No. 3862/97, 14/05/2002)

<sup>32</sup> Shihni nenin 4. paragrafi 1. pika 9. e LMD

**2.1.10. Diskriminimi i shumëfishtë** paraqitet kur diskriminimi është bazuar në cilin do kombinim sipas bazave të mbrojtura ligjore. Diskriminimi i shumëfishtë dhe baza e shumëfishtë interpretohet në bazë të rrethanave.<sup>33</sup>

Diskriminimi i shumëfishtë është formë e vështirë e diskriminimit sepse pasojat e saj negative janë shumë më të mëdha në raport me viktimën.

**2.1.11. Shkelja e parimit të drejtave dhe detyrimeve të barabarta** Shkelja e parimit të trajtimit të barabartë në baza të mbrojtura ligjërisht konsiderohet diskriminim.<sup>34</sup>

Në mënyrë që trajtimi i barabartë të paraqesë diskriminimin, duhet të bazohet në ndonjë karakteristikë personale, sikurse janë p.sh: gjinia, orientimi seksual, nacionaliteti, gjuha, feja dhe të tjera. Prandaj, personi i është ekspozuar trajtimit jo të barabartë pikërisht për karakteristikën e vetë personale, dhe jo për shkak të tipareve të tij të karakterit dhe tipareve tjera, shprehive etj.

Kushti i parë për përcaktimin e shkeljes së parimit të drejtave dhe detyrimeve të barabarta është mohimi i ndonjë të drejte, apo imponimi i ndonjë obligimit personit apo grupit të personave, e cila në situatë të njëjtë apo të ngjashme me të tjerët, nuk mohohet ose imponohet.

Kushti i dytë për përcaktimin e këtij lloji të diskriminimit është që mohimi i të drejtës apo imponimi i obligimit të jetë i bazuar në ndonjë karakteristikë të tyre personale.

Kushti i tretë është mos-justifikimi i qëllimit apo pasojat e masave të ndërmarra.

Kushti i katërt është mosekzistimi i proporcionit midis masave të ndërmarra dhe qëllimit i cili me këto masa realizohet.

Nganjëherë ndodhë që ndaj ndonjë personi vërtetë të veprohet në mënyrë jo të barabartë, por kjo sjellje nuk mundet të karakterizohet sikur diskriminim sepse nuk është bazuar në ndonjë karakteristikë personale të atij personi.

Lista e karakteristikave personale në Ligjin mbi ndalimin e diskriminimit është mjaftë shterues por nuk është i mbyllur, gjë që është posaçërisht e rëndësishme, sepse mundësohet zgjerimi i saj edhe në karakteristika tjera të cilat nuk janë theksuar shprehimisht në ligj.

## **2.2. Format e rënda të diskriminimit**

Sjellja diskriminuese e cila është motivuar me më shumë se një bazë të mbrojtur ligjërisht apo e cila është bërë më shumë se një herë apo e cila ka zgjatur më shumë apo ka pasur pasoja të cilat janë posaçërisht të dëmshme për viktimën, konsiderohet formë e rëndë e diskriminimit.<sup>35</sup>

---

<sup>33</sup>Shih nenin 4. paragrafi 1. pika 10. e LMD

<sup>34</sup>Shih nenin 4. paragrafi 2. i LMD

<sup>35</sup> Shihni nenin 5. LMD

### 2.3. Veprimet afirmative

Veprimet afirmative paraqesin masat e posaçme të ndërmarra me qëllim të parandalimit apo kompensimit joadekuat të grupeve të cenushme apo personave të cenushtëm në lidhje me ndonjërin prej bazave të mbrojtura ligjrisht.

Edhe vetë Kushtetuta parasheh realizimin dhe miratimin e masave të përkohshme, të domosdoshme për mbrojtjen dhe avancimin e drejtave të individëve dhe grupeve të cilat nuk janë të barabarta. Masat e tilla mund të realizohen vetëm deri në arritjen e qëllimit për të cilin janë themeluar. Masat e tilla të ndërmarra nuk do të konsiderohen si akte diskriminimi.<sup>36</sup>

Masat afirmative sipas LMD-së, faktikisht do të thotë devijim nga parimi themelorë i barazisë formale, por nuk konsiderohen diskriminime dhe kanë bazë të posaçme ligjore dhe zbatohen vetëm deri sa mos të arrihet qëllimi për të cilin janë vendosur këto masa.<sup>37</sup>

Masat afirmative janë masa të ndryshme ligjore dhe të tjera të cilat ndërmerren në mënyrë që grupet e caktuara shoqërore, të cilat faktikisht gjenden në pozitë vartëse dhe pozita e të cilëve në shoqëri është e keqe, të arrijnë barazinë reale. Për këto arsye duhet ndërmarrë masa të caktuara afirmative, me të cilat personave i jepet përparësi e caktuar, në mënyrë që të vijnë në të njëjtën pozitë të cilën e kanë qytetarët tjerë dhe në mënyrë që t'i krijohen kushtet që në mënyrë të barabartë të gëzojnë të gjitha drejtat sikurse edhe qytetarët tjerë.

Shembull: Institucionet publike të Kosovës janë të obliguara që të ndërmarrin masat e përkohshme të posaçme në mënyrë që të përshpejtohet realizimi i barazisë konkrete të grave dhe burrave në ato fusha ku ekzistojnë pabarazitë.<sup>38</sup> Kjo është masë e posaçme me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinorë dhe arritjes së barazisë gjinore në institucionet e sistemit të Republikës së Kosovës, në të gjitha nivelet e pushtetit ekzekutiv dhe gjyqësor legjislativ, duke përfshirë edhe institucionet tjera publike. Është futur për shkak të pjesëmarrjes së numrit të vogël të grave në institucionet e sistemit në vendimmarrje dhe jetën publike të Kosovës.

Megjithatë dhënia e përparësisë një kandidati i cili i përket gjinisë më pak të përfaqësuar nuk mundet të jetë automatike dhe e pakushtëzuar, por mundet të injorohet në rast se arsyet specifike të një kandidati mund të jenë në favor të tij/saj.<sup>39</sup>

Në vendimet ligjore të Kosovës të cilat kohe kanë të bëjnë me “masat e posaçme” përdorimi i shprehjes “gjini më pak e përfaqësuar”, gjë që mundëson që kjo dispozitë mundet të zbatohet edhe për meshkujt – në rast se dikur, në të ardhmen, të ketë më shumë femra.

### 3. Mbrojtja nga diskriminimi

Me miratimin e LMD-së, Republika e Kosovës ka krijuar mekanizma të ndryshme të mbrojtjes në raste të diskriminimit dhe secili prej tyre ka qëllimin dhe objektivin e vetë. Disa mekanizma përdoren për të parandaluar përsëritjen dhe eliminuar pasojat e diskriminimit me qëllim të mbrojtjes së viktimës nga diskriminimi dhe të tjerët përdoren në mënyrë që diskriminuesi të

<sup>36</sup> Shihni nenin 24. dhe nenin 58. të Kushtetutës

<sup>37</sup> Shihni nenin 7. LMD

<sup>38</sup> Shihni nenin 5. dhe 6. të Ligjit mbi barazinë gjinore, nr 05/L-020

<sup>39</sup> Njëjtë.

ndëshkohet për atë çfarë ka bërë. Këta mekanizma varësisht nga nevoja mundën të përdoren në mënyrë individuale dhe të kombinuara.

LMD, në lidhje me sjelljen diskriminuese sipas bazës së mbrojtur juridike, për mekanizma të mbrojtjes e parashihet Institucionin e Avokatit të Popullit dhe mbrojtjen gjyqësore nga diskriminimi.

### **3.1. Mbrojtja gjyqësore nga diskriminimi**

Viktimat e diskriminimit mundën të kërkojnë që mbi të drejtat e tyre dhe kënaqshmërinë të vendoset në procedurën e duhur gjyqësore (proces gjyqësorë, penal dhe kundërvajtës), pranë gjykatës kompetente. Padia për mbrojtje nga diskriminimi mundet të paraqitet më së largu pesë vite nga dita kur i dëmtuar ka marrë vesh për shkeljen.<sup>40</sup>

LMD parashikon që viktima e diskriminimit mundet që me padi në procedurë gjyqësore, nga gjykata të kërkojë ofrimin e mbrojtjes ligjore nga diskriminimi. Shoqatat, organizatat apo subjektet tjera ligjore mundën të iniciojnë apo përkrahin procedurat ligjore në emër të parashtruesit, pas marrjes së pëlqimit të tyre për mbajtjen e procedurave administrative apo gjyqësore të parapara për realizimin e obligimeve nga ky ligj.<sup>41</sup>

Pas përcaktimit të diskriminimit gjykata mundet të vendosë si në vijim: që t'i ndalojë të paditurit kryerjen e mëtejme të veprimeve diskriminuese, dhe t'i urdhërojë të paditurit të eliminojë të gjitha veprimet diskriminuese ndaj paditësit; të vendosë dhe kompensojë dëmet materiale dhe jo materiale të cilat i pa vuajtur personi i diskriminuar shkakun e diskriminimit, sipas padisë për kompensim; të urdhërojë masat e përkohshme në përputhje me dispozitat e ligjit të duhur mbi procedurën penale; të urdhërojë afat më të shkurtër kohorë për atë ekzekutim, sesa është paraparë me ligjin relevant mbi procedurën përmbarimore; në media të publikojë vendimin gjyqësorë, me të cilin vërtetohet shkeljen e të drejtave në trajtim të barabartë.

Pala e pakënaqur mundet të parashtojë ankesë kundër vendimit të shkallës së parë në afat prej shtatë (7) ditëve Gjykatës së apelit, sipas ligjit relevant mbi procedurën kontestimore. Paditësi, me padi për mbrojtje nga diskriminimi, mundet të theksojë më shumë kërkesa dhe të përcaktojë cilat lloje të mbrojtjes ligjore do të kërkojë nga gjykata.<sup>42</sup>

Procedurat gjyqësore në rastet e diskriminimit duhet të trajtohen në procedurë urgjente.<sup>43</sup>

Rastet e diskriminimit të cilat prekin gupet e personave se mundën të iniciohen përmes veprimit gruporë në emër të tyre nga ana e organizatës joqeveritare apo Avokatit të Popullit, në raste të tilla nuk i nevojitet pëlqimi i pjesëmarrësit të grupit.

Në këtë rast, paditësi në padi nga gjykata kompetente mundet të kërkojë: të vendosë se sjellja e tillë ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë në raport me anëtarët e grupit; të ndalojë

---

<sup>40</sup> Shihni nenin 14. LMD

<sup>41</sup> Shihni nenin 13. LMD

<sup>42</sup> Shihni nenin 16. LMD

<sup>43</sup> Po aty.

ndërmarrjen e veprimeve të cilat shkelin apo munden të shkelin të drejtën në trajtim të barabartë apo të kryejnë veprime të cilat eliminojnë diskriminimin apo pasojat e të njëjtës në raport me pjesëmarrësit e grupit; të publikojë në media vendimin me të cilin përcaktohet shkelja e të drejtave në trajtim të barabartë me shpenzime të paditurit. Kërkesa për dëmshpërblim mundet të kërkohet në bazë të aktgjykimit në rast të veprimit gruporë. Personat të cilat i përkasin grupit të përmendur munden të iniciojnë padi dhe të kërkojnë kompensimin e dëmit.<sup>44</sup>

Viktimat e veprave penale me elementet të diskriminimit kanë mundësinë e vetme që t'i drejtohen policisë dhe prokurorit kompetent, i cili është i autorizuari i vetëm që të iniciojë hetimin dhe të iniciojë fillimin e procedurës penale me parashtrimin e aktakuzës. Shkelja e dispozitave të këtij ligji, në rastet kur paraqesin vepër penale janë të dënueshme sipas dispozitave të Kodit penal të Republikës së Kosovës.<sup>45</sup>

Për mbrojtjen ligjore kundërvajtëse kundër diskriminimit, LMD në “dispozitat kundërvajtëse” i ka përcaktuar dënimet për kundërvajtje.<sup>46</sup>

### **3.2 Barra e argumentimit**

Kur personat të cilat konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre paraqesin argumente pranë autoritetit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mundet supozuar se ka ekzistuar diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë. Barra e argumentimit bie në palën e paditur, e cila duhet të argumentojë se nuk ka ekzistuar shkelje e parimit të trajtimit të barabartë.<sup>47</sup>

Kjo do të thotë se paditësi duhet ta bëjë të mundshme se deri tek diskriminimi ka ardhur dhe se i padituri e ka vendosur në pozitë më të pafavorshme për shkak të karakteristikave të tij, gjegjësisht, se në raport me atë është shkelur parimi i barazisë, atëherë i padituri diskriminues është i obliguar të me trajtimin konkret nuk është shkelur ky parim. Në rast se i padituri nuk arrin ta bëjë këtë, gjykata do të vendosë se është bërë diskriminimi dhe se është shkelur parimi i barazisë.

### **3.3. Mbrojtja nga diskriminimi para Institucionit të Avokatit të Popullit**

Institucioni i Avokatit të Popullit është një mekanizëm shtetëror i pavarur për promovimin e barazisë, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura me ligj.<sup>48</sup> Avokati i popullit merret me çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin në përputhje me kompetencat të përcaktuara me Ligjin për Avokatin e Popullit<sup>49</sup> dhe Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

---

<sup>44</sup> Shih nenin 18. LMD

<sup>45</sup> Shih nenin 17. LMD

<sup>46</sup> Shih nenin 23. LMD

<sup>47</sup> Shih nenin 20. LMD

<sup>48</sup> Shih nenin 1, Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019

<sup>49</sup> Shih nenin 16, Ligji për Avokatin e Popullit, me të cilin janë precizuar kompetencat e Avokatit të Popullit.



LMD parasheh Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) të jetë organi kryesor në luftën kundër diskriminimit dhe ka këto kompetenca: pranon dhe heton parashtrirat e personave, ndërmjetëson, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit; ofron asistencë viktimave të diskriminimit në bërjen e ankesave kundër diskriminimit dhe ofron informatat e domosdoshme personave që kanë paraqitur një ankesë për diskriminimin në lidhje me të drejtat e tyre, për detyrimet dhe mundësitë e gjykatës, si dhe për mjetet tjera mbrojtëse; heton apo vepron mbi ndonjë ankesë të parashtruar ose me vetë-iniciativë (ex-officio) kur ka bazë për të dyshuar se ka ndodhur diskriminimi nga subjektet e sektorit publik: u drejtohet organeve të prokurorisë dhe të hetimit direkt me një kërkesë për fillimin e hetimit të kundërvajtjeve dhe veprave penale dhe kërkon fillimin e procedimit disiplinor të zbatueshëm; informon publikun për rastet e diskriminimit dhe ndërmerr masa për promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimin; përcjell zbatimin e këtij ligji dhe inicion ndryshimin e dispozitave për zbatimin edhe avancimin e mbrojtjes nga diskriminimi; ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje, subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikatat e mira në promovimin e barazisë, në përshtatjen ndaj diversitetit dhe parandalimin e diskriminimit mbi bazat e mbuluara nga Ligji përkatës për Barazi Gjinore dhe nga ky Ligj, si dhe jep rekomandime për marrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit; ofron këshilla, mbështetje dhe udhëzime organizatave joqeveritare dhe partnerëve social në praktikatat e mira dhe efektive në luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë, në veçanti organizatave që merren me çështjet e barazisë dhe jo-diskriminimin; jep mendime për projekt – aktet normative për mbrojtjen nga diskriminimi; mbledh të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera, realizon studime, hulumtime dhe trajnime, në lidhje me diskriminimin; bashkëpunon me partnerët social, organizatat joqeveritare, që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me mekanizmat përkatës të shteteve tjera që merren me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe me institucionet dhe bashkësitë fetare të regjistruara në Kosovë; paraqet raport së paku çdo vit në Kuvendin e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij Ligji dhe gjithashtu mund të hartojë raporte të veçanta për zbatimin e tij; mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi; mund të hartojë kode të Praktikave të Mira për luftimin e diskriminimit dhe për promovimin e barazisë, të cilat mund të përdoren si pikë referimi në rastet e diskriminimit.<sup>50</sup>

### **3.3.1. Ankesat kundër diskriminimit në Institucionin e Avokatit të Popullit**

Çdo person fizik ose juridik apo grup i personave mund të parashtrojë ankesë në IAP në lidhje me çdo sjellje diskriminuese. Paraqitja dhe trajtimi i ankesës ndaj diskriminimit nga ana e IAP-së bëhet në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe në përputhje me Ligjin e veçantë për mbrojtje nga diskriminimi<sup>51</sup> dhe Ligjin për Barazi gjinore<sup>52</sup>. Paraqitja e ankesës tek Avokati i Popullit nuk është kusht për inicionin e padisë dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar që t'i drejtohet gjykatës apo organeve të ndjekjes penale. Shoqatat,

---

<sup>50</sup> Shih nenin 9, LMD.

<sup>51</sup> Po aty.

<sup>52</sup> Shih nenin 13, Ligji për Barazi gjinore.

organizatat apo subjektet tjera juridike mund të iniciojnë apo përkrahin ankesat në emër të parashtruesit, me marrjen e pëlqimit të tyre, për zhvillimin e procedurave tek IAP.<sup>53</sup>

Pranimi, hetimi dhe trajtimi i ankesave dhe kërkesave për mbrojtje nga diskriminimi bëhen nga Departamenti për Mbrojtje nga Diskriminimi, siç është përcaktuar në Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IAP.<sup>54</sup>

Ankesa mund të parashtrohet personalisht, në njërën prej zyrave të IAP-së, duke e dërguar me postë, postë elektronike apo nëpërmjet faksit në adresë të IAP-së, nëpërmjet thirrjes telefonike apo kutive të ankesave të IAP-së që janë të vendosura në të gjithë vendet ku gjenden personat që janë të privuar nga liria. IAP siguron formularin për parashtrimin e ankesës dhe i njëjti është në dispozicion në ueb faqen e IAP-së. Ankesat duhet të jenë të arsyetuara, dhe të përcjella me dokumentacion relevant. IAP nuk pranon ankesa apo kërkesa anonime. Procedura në IAP është pa pagesë.

Pas përfundimit të procedimit të lëndës dhe pasi është konfirmuar që është kryer diskriminimi, Avokati i Popullit në përputhje me kompetencat e tij, nxjerr dhe i dërgon institucionit përgjegjës mendimin apo raportin me rekomandimet përkatëse dhe masat që duhet të ndërmerren në rastin konkret, me qëllim të eliminimit dhe parandalimit të diskriminimit.<sup>55</sup>

Institucioni i Avokatit të popullit mbikëqyr përgjigjet e institucioneve publike në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të dërguara.

Nëse pas rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit, autoritetet administrative apo zyrtari përkatës nuk ndërmarrin masat e duhura brenda afatit të caktuar apo nuk e arsyetojnë moszbatimin e rekomandimeve të dhëna, Avokati i Popullit e përcjell këtë çështje në Kuvendin e Kosovës dhe mund të dalë me komunikatë për shtyp.

Nëse konstaton që në rastin konkret nuk është kryer diskriminim, në vendimin e tij Avokati i Popullit jep mendim në të cilin deklaron qëndrimin e tij.

Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi, dhe të jep mendimin e tij nëse këto raste janë paraqitur dhe trajtuar nga ana e IAP-së.

LMD, gjithashtu precizon rolin edhe të një organi institucional, që është Zyra për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, në promovimin dhe zbatimin e LMD-së dhe si organ që monitoron zbatimin e rekomandimeve që i ka dhënë Avokati i Popullit. Përveç tjerash, LMD përcakton edhe mekanizmat institucional për mbrojtje nga diskriminimi nëpër ministri dhe komuna.<sup>56</sup>

---

<sup>53</sup> Shih nenin 12 dhe 13. LMD.

<sup>54</sup> Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në IAP 01-2016

<sup>55</sup> Për informata më të hollësishme, shih Rregulloren e punës së IAP-së 02/2016, e qasshme në: <http://ombudspersonkosovo.org/pravni-akti>

<sup>56</sup> Shih nenin 10. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi.

## **4. Legjislacioni për ndalimin e diskriminimit**

### **4.1. Legjislacioni ndërkombëtar**

Karta e Kombeve të Bashkuara, 1948.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Konventa e OKB-së mbi eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit, 1965,

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966,

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1966,

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, 1989, –

Konventa Ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit të grave, 1979,

Konventa e OKB-së për të Drejtat e personave me aftësi të Kufizuar, 2006,

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950.

Konventa Evropiane për parandalimin e torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve tjera mizore, jonjerëzore e poshtëruese, 2002.

Karta Evropiane për gjuhët rajonale apo të pakicave kombëtare, 1992.

Konventa kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, 1994.

Konventa e Stambollit për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje,

Rekomandimet e Oslos lidhur me të drejtat gjuhësore të pakicave kombëtare, 1955,

Rekomandimi CM/Rec(2010)5 të Komitetit të ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të

Evropës mbi masat për luftën kundër diskriminimit në bazë të orientimit seksual apo identitetit gjinor,

*Rekomandimi i Komitetit të Ministrave për shtete anëtare mbi gjuhën e urrejtjes (R(97) 20)*, i miratuar në vitin 1997.

„Deklarata e Strasburgut për romët“, Takim i nivelit të lartë të Këshillit të Evropës për romët, Strasburg, 2010.

Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e datës 29 qershor 2000 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pa marrë parasysh prejardhjen racore ose etnike,

Direktiva e Këshillit të Evropës 2000/78/EC, e datës 27 nëntor 2000, për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës,

Direktiva e Këshillit të Evropës nr. 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime të Këshillit të Bashkimit Evropian,

Direktiva e Këshillit të Evropës 2006/54/EC, e datës 5 korrik 2006 për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës.

### **4.2. Legjislacioni vendor**

Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, nr. 05-L-021

Ligji për barazinë gjinore, nr. 05-L-20

Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 05-L-019

Ligji për personat e verbër, nr. 04/Z-092

Ligji për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, nr. 05/L-067

Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, nr. 03/L-019, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078

Ligji për shëndetin mendor, nr. 05/L-025

Ligji për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, nr. 03/L-022

#### **4.2.1. Dispozitat përkatëse të legjislacionit të mëposhtëm**

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti, nr. 04/L-131

Ligji për shërbime sociale dhe familjare, nr. 02/L-17, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081

Ligji për edukimin parashkollor, nr. 02/L-52

Ligji për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068

Ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032

Ligji për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-037

Ligji për provimin e maturës shtetërore, nr. 05/L-018, Ligji për shëndetësi, nr. 04/L-125

Ligji për sigurimin shëndetësor, nr. 04/L-249,

Ligji për ndërtim, nr. 04/L-110, Udhëzim administrativ nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara

Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, nr. 03/L-047

Ligji për përdorimin e gjuhëve, nr. 02/L-37

Ligji i punës, nr. 03/L-212

Ligji për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientin e punës, nr. 203/19

Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-149

Kodi Penal nr. 04/L-082

Ligji për lirinë fetare, nr. 02/L-31

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje, nr. 03/L-182

Rregullore nr. 03/2017 për mekanizmat institucional për mbrojtjen nga diskriminimi në Qeveri dhe komuna,

Rregullore nr. 07/2012, për Zyrën e Komisionarit për gjuhët,

Rregullore nr. 13/2017, për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrit, Udhëzim administrativ nr. 09/2016, për aplikimin e masave afirmative numrit të mbrojtur për regjistrimin e studentëve pjesëtarë të komuniteteve pakicë në institucionet publike të arsimit të lartë,

## LITERATURA

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008.

Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 05-L-019

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nr. 05-L-021

Ligji për Barazinë Gjinore, nr. 05-L-020

Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, nr.01-2016, e qasshme në: <http://ombudspersonkosovo.org/pravni-akti>

Rregullorja e punës nr. 02-2016, e qasshme në: <http://ombudspersonkosovo.org/pravni-akti>

Direktiva e Këshillit 2000/43/EC e datës 29. qershor 2000 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave pa marrë parasysh prejardhjen racore ose etnike,

Direktiva e Këshillit të Evropës 2000/78/EC, e datës 27. nëntor 2000, për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtim të barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës,

Komisioni Evropian, *Luftimi i diskriminimit, Manual për trajnim*, 2006. [DE – EN – FR]

Agjencia për të drejtat themelore të BE-së dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut –

Këshilli i Evropës. *Manual për Legjislacionin Evropian për ndalimin e diskriminimit*,

2011, [http://fra.europa.eu/fraWebsite/attachments/FRA-CASE-LAW-HANDBOOK\\_EN.pdf](http://fra.europa.eu/fraWebsite/attachments/FRA-CASE-LAW-HANDBOOK_EN.pdf)

Manual për të drejtën antidiskriminuese evropiane, Agjencia për të drejtat themelore e BE-së,

2010. Këshilli i Evropës. [file:1510-FRA\\_CASE\\_LAW\\_HANDBOOK\\_HR%20\(2\).pdf](file:1510-FRA_CASE_LAW_HANDBOOK_HR%20(2).pdf)

Publikimet e Rrjetit Evropian të ekspertëve ligjor në fushën e ndalimit të diskriminimit, duke përfshirë Vështrimin e të drejtës antidiskriminuese evropiane,

[www.nondiscrimination.net/publications](http://www.nondiscrimination.net/publications);

## SHTOJCË

### TEST PËR PËRCAKTIMIN E DISKRIMINIMIT

Në vazhdim gjendet shembulli i testit në bazë të cilit mundet të identifikohet nëse trajtimi i kontestueshëm për veprim apo mosveprim, apo masa e kontestueshme ndaj një personi/grupi personash, në aktin e përgjithshëm ose individual, paraqet shkeljen e parimeve të mundësive të barabarta dhe ka karakteristika të diskriminimit.

Shembull: Për identifikimin e diskriminimit i cili në praktikë paraqitet në formë të **Shkeljes së drejtave dhe detyrimeve të barabarta**, duhet të përcaktohet si në vijim:

1. Të identifikohet personi/grupi i personave me të cilin ka të bëjë mohimi i ndonjë të drejte, apo vendosja e ndonjë obligimi. Gjegjësisht, a është individ apo grup i personave?
2. Të identifikohet cila bazë e mbrojtur me ligj, gjegjësisht cila karakteristikë personale është bazë e diskriminimit të individit/grupit të personave, (kombësia apo lidhja me ndonjë komunitet, origjina shoqërore apo nacionale, raca, përkatësia etnike, ngjyra e lëkurës, lindja, prejardhja, gjinia, përkatësia gjinore, identiteti gjinorë, orientimi seksual, gjuha, nënshtetësia, religjioni dhe bindjet fetare, përkatësia politike, opinionimi politik apo i ndryshueshëm, gjendja shoqërore apo personale, mosha, gjendja martesor apo familjare, shtatzënia, amësia, gjendja pasurore, gjendja shëndetësore, aftësitë e kufizuara, trashëgimia gjenetike apo ndonjë bazë tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë).
3. A është situata në të cilën gjendet personi/grupi i personave e njëjtë apo e ngjashme në krahasim me personat e tjerë apo bëhet fjalë për trajtimin e njëjtë të personave/grupit të personave të cilët gjenden në situata të ndryshme?
4. Qëllimi i cili dëshirohet të arrihet me masat e ndryshme të ndërmarra a është në përputhje me arsyet e ligjshme dhe kuptueshme gjegjësisht a është i arsyeshëm/paarsyeshëm?
5. A ekziston ndonjë proporcion midis masave të ndërmarra dhe qëllimit i cili arrihet me masat e ndërmarra?

Në rast se vërtetohet se veprimi i kontestueshëm është i arsyetuar me faktorë objektiv të cilët nuk janë në lidhje me kurrfarë diskriminimi në bazë të bazës së caktuar ligjore, si dhe në kurrfarë lidhje me personin/grupin e personave me bazë të tillë dhe nëse masa kontestuese apo akti ka qëllim legjitim dhe në rast se nuk ekziston masë tjetër me të cilën mundet të realizohet qëllimi i njëjtë legjitim, atëherë këtë janë arsye të kuptueshme të cilat nuk kanë karakteristika të diskriminimit. Nëse rasti nuk është i tillë atëherë veprimi i tillë i kontestueshëm paraqet shkeljen të parimit të veprimit të barabartë dhe ka karakteristika të diskriminimit.